

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE 16 QERSHOR 2022

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

E nderuar Kryetare,

Në Shqipëri bujqësia ngelet sektori kryesor për shkak të resurseve që ajo ka, por edhe për numrin e konsiderueshëm të popullsisë që merret me bujqësinë. Në këtë sektor janë të punësuar më shumë se 450 mijë persona, por zbatimi i ligjit nr. 7501, që ka bërë copëtimin e saj dhe mosmbështetja, e kanë venitur këtë sektor mjaft të rëndësishëm. Unë e konsideroj të jashtëzakonshëm kontributin e zotit Duka ndaj këtij sektori shumë të rëndësishëm, duke qenë konkret, pasi i jep zgjidhje disa gjërave, por nuk është gjithçka çfarë ajo ofronte.

Mbështetja në afat 5-vjeçar; heqja dorë nga kufizimet e numrit, është vërtet absurde. Si mundet që një person, i cili ka më shumë se 100 krerë, mund të quhet “oligark” dhe duhet të marrë kontribut, kurse dikush që ka 99 e më pak nuk duhet të marrë? Pra, si mundet që dikush që ka shumë hektarë apo dynim mund të marrë, kurse dikush që ka më pak nuk duhet të marrë? Madje, jo vetëm kaq, por si në kohën e diktaturës, kush vendos shishen e qumështit i pari, ai merr bukë; po mbaroi buka, nuk merr. E njëjta gjë ndodh edhe me subvencionimet. Pra, përfitojnë vetëm ata të parët që shkojnë dhe kuptohet, edhe ata me selektim. Unë e konsideroj të jashtëzakonshëm këtë kontribut, por nuk u mor në konsideratë dhe më bën përshtypje tri gjëra: Së pari, më bëri përshtypje komisioni ku unë jam anëtar, që maxhoranca në mënyrë unanime shprehu qëndrimin e saj kundër.

Së dyti, më bëri shumë përshtypje zëvendësministri i Bujqësisë, kur tha: “Do të hartojmë strategjinë 2021-2025-2027 dhe më pas do ta planifikojmë”. Pra, në vitin 2022 do të bëjmë një strategji për vitin 2021 deri në vitin 2027. E treta, zoti Balla tha: “Nuk e kemi futur, sepse bie ndesh me paketën fiskale të vitit 2022. Çfarë lidhje ka kjo me paketën fiskale? Në paketën

“Duka” parashkruhet se duhen të paktën 8 muaj për të bërë aktet nënligjore dhe për ta bërë të zbatueshme, që do të thotë se edhe për vitin 2023 ndoshta nuk mund të fillojë të japë efektet në datën 1 janar.

Tri argumentet që unë thashë tregojnë vullnetin e kësaj qeverie për të mos u marrë me këtë sektor mjaft të rëndësishëm, siç është bujqësia. Në fakt, sot bujqësia ndodhet në pikë të hallit, sepse çdo lloj instrumenti që ne marrim, është më keq se sa në vendet e rajonit. Mjafton të shikosh statistikën edhe pas pandemisë. Në raportin e Bankës Botërore thuhet se gjatë kohës së pandemisë vetëm 0,3% e prodhimit të brendshëm bruto u dha për pandeminë, në një kohë kur vendet e tjera kanë 10-20 herë më shumë. Ky është kontributi i paktë i Shqipërisë. Nuk mjafton vetëm kjo, por në statistikën e Organizatës së Ushqimit të Kombeve të Bashkuara thuhet se në Shqipëri jepet më pak ndihmë për bujqësinë se në asnjë vend tjetër të rajonit, me mbështetje në mënyrë të drejtpërdrejtë me vetëm 3 dollarë për hektar.

Nëse u referohemi vendeve të tjera të rajonit, jemi në diferencë të theksuar, jemi në fundin e tabelës. Këto tregojnë edhe një herë qartë mosangazhimin e kësaj qeverie për t'i dhënë mbështetjen e duhur këtij sektori mjaft të rëndësishëm. Një tjetër instrument që ka ndikuar negativisht për bujqësinë janë ndryshimet në mënyrë permanente të paketës fiskale. Nëse do të shikoni, në vitin 2017 TVSH-ja rimburshej 20%, më pas zbriti në 10% dhe më pas në 0%. Ky fakt e prishi tregun dhe krijoi kushte të disfavorshme për bujqësinë. Po të shikojmë, është i rrënuar jo vetëm sektori i bujqësisë, por e njëjta gjë ndodh edhe te përpunimi i qumështit apo tek ullinjë.

Paketa fiskale e miratuar në fillim vitit i shtrihen efektet e saj më 1 korrik, dhe aty thuhet se gazi do të rritet me 6 lekë. Pra, do të rritet më tej kostoja e fermerëve. Më e rëndësishmja është që janë trefishuar çmimet e produkteve. Sot një kuintal nitrat apo ure shkon 130 mijë lekë. Autokombajna për të shirë 1 dynim grurë, harxhon 25 mijë lekë, gjë që e ka bërë të vështirë situatën në bujqësi. E njëjta situatë do të ndodhë edhe me ullinjë, sepse parashikohet që deri në fund të këtij viti çmimi i energjisë elektrike për biznesin të shkojë nga 18,8 në 32 lekë, që do të thotë se do të japë një impakt negativ për një tjetër sektor të rëndësishëm siç është vaji i ullirit, që do të ketë një rritje të mëtejshme gjatë këtij viti.

Në Shqipëri ndodhin çudira, sepse sapo janë bërë publike të ardhurat e realizuara për 4-mujorin e parë të këtij viti. Nëse do të krahasojmë këtë vit, që jemi vit lufte, vit krize, nga qeveria, krahasuar me vitin e kaluar, e dini sa janë realizuar? 420 miliardë lekë të vjetra ose 350 milionë euro. Ky është grafiku, këto janë të ardhurat. Vetëm në Shqipëri ndodh që në kohë krize shteti përfiton 350 milionë euro dhe ka dhënë maksimumi 50 milionë euro, të cilat edhe ato kanë qenë pjesë e inflacionit të vitit të kaluar. Pra, 1 nga 9 pjesët u është dhënë qytetarëve, kurse 8 pjesët e tjera i ka përdorur qeveria. Është vërtet skandaloze.

A nuk do të ishte normale që kjo sasi e konsiderueshme të ardhurash, që është krijuar, të shkojë në një sektor tjetër që mund ta ndihmojë dhe ta nxjerrë ekonominë nga kolapsi? A nuk do të ishte normale që kjo shumë prej 35 milionë eurosh t'i jepej konsumatorit? Vetëm konsumatori mund ta mbajë gjallë ekonominë. A nuk do të ishte normale që të ulnim borxhin publik, pra këta 350 milionë euro të mos shkonin për të paguar interesat e viteve të kaluara? A nuk do të ishte normale sikur të subvencionohej bujqësia, ky sektor mjaft i rëndësishëm? Pra, këto para të shkonin në mbështetje të bujqësisë.

A nuk do të ishte normale sikur kjo qeveri të ulte taksat, apo tatimin, apo akcizën e karburantit, që do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë te bujqësia? Kjo nuk ndodh, sepse qeveria nuk e ka prioritet sektorin e biznesit, aq më tepër zonat rurale. Ajo përdor çdo instrument për ta shpopulluar, siç ishte ndarja territoriale, siç është selektimi në subvencione, që kush ka shumë mund të paguhet dhe kush ka pak nuk mund të subvencionohet nga buxheti i shtetit, por edhe me shumë instrumente të tjera. Ministret e shesin deficitin tregtar sikur janë rritur shumë eksportet, është e vërtetë që janë rritur eksportet, por ato janë rritur për shkak të rritjes së çmimit.

Rritja më e madhe ka ndodhur tek importi, pra deficitin tregtar ka një shifër marramendëse, është 123 miliardë ose më shumë se 1 miliard euro në nxjerrim nga Shqipëria. Kjo vjen për shkak të politikës që përdor kjo qeveri. Qeveria duhet ta stimulojë bujqësinë, sepse është i vetmi instrument me të cilin ne mund të konkurrojmë. Një banor nga Peshkopia, madje nga fshati i Ulsiut, më tha se po i hedhin qershitë, sepse nuk jua marrin as me 20 apo 30 lekë. Edhe

ai që guxon të vijë në Tiranë për t'i shitur, paguan aq sa bëjnë qershitë për t'i mbajtur në tregun e Tiranës.

Pra, ky është standardi që ne kemi krijuar. Po të shikojmë çmimin e karburantit, që është i fundit, besoj se ka efekt pozitiv nëse hiqet akciza dhe jam i sigurt që do të ndikojë pozitivisht jo vetëm te bujqësia, por edhe tek ekonomia shqiptare. Faleminderit!